

**BARKODI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE**

**LËNDA: GJEOGRAFI**

**Udhëzime për maturantin/kandidatin**

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrrathët përkatës të tabelës në fletë përgjigje:

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletë përgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim dhe arsyetim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	5	7	10	12	14	22	23
Pikët							
Kërkesa	24	25	26	31	32	33	34
Pikët							

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Si pasojë e qarkullimit të Tokës rreth Diellit ndodh:

1 pikë

- A) formimi i stinëve;
- B) formimi i ditë-natës;
- C) ndryshimi i orës zonale;
- D) ndryshimi i orës lokale.

2. Meridianët shërbejnë për të përcaktuar:


1 pikë

- A) gjatësinë gjeografike;
- B) gjerësinë gjeografike;
- C) madhësinë në gradë të ekuatorit;
- D) madhësinë në gradë të Rrethit Polar Verior.

3. Cila nga pikat e dhëna në figurë ka gjerësi gjeografike më të vogël?

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



4. Vijat që bashkojnë vende me trysni atmosferike të njëjtë quhen:

1 pikë

- A) izohipse;
- B) izohieta;
- C) izobate;
- D) izobare.

5. Vëzhgoni me kujdes figurën e dhënë.

a) Cili lloj i projeksionit hartografik është përdorur?

1 pikë


\_\_\_\_\_

b) Si paraqiten meridianët në këtë lloj projeksioni?

1 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



6. Një nga pasojat e shpërthimeve të mëdha vullkanike është:

1 pikë

- A) zvogëlimi i sasisë së grimcave të pluhurit në atmosferë;
- B) rritja e reflektimit të rrezeve të Diellit në atmosferë;
- C) varfërimi i tokave;
- D) ftohja e klimës.

7. Analizoni të dhënat e grafikut të mëposhtëm dhe më pas përcaktoni llojin e klimës që paraqet ai.

3 pikë

---



---




---



---



---



8. Cili është faktori kryesor që ndikon në formimin e rrymave oqeanike?


1 pikë

- A) Tërmetet.
- B) Vullkanet.
- C) Erërat lokale.
- D) Erërat e qarkullimit të përgjithshëm.

9. Cilin nga elementet e valës tregon shkronja D në figurën e mëposhtme?

1 pikë

- A) Bazën.
- B) Gjatësinë.
- C) Kreshtë.
- D) Lartësinë.



10. Atmosfera është mbështjella e gaztë, që e rrethon Tokën.

a) Cili është gazi me përqindjen më të lartë në atmosferën e Tokës?

1 pikë

---

b) Jepni dy veçori të shtresës së troposferës.

2 pikë

---



---

11. Cila nga erërat e mëposhtme është me origjinë nga Saharaja?

1 pikë

- A) Murlani.
- B) Shiroku.
- C) Musoni.
- D) Fëni.

12. Shpjegoni si formohen secili prej shkëmbinjve të mëposhtëm.

2 pikë

Shkëmbinj të sedimentarë:

Shkëmbinj të metamorfikë:

13. Tjetërsimi fizik që ndodh për shkak të ngricave, shfaqet më shumë në:

1 pikë

- A) zonat e pyjeve me lagështirë;
- B) zonat ekuatoriale;
- C) zonat shkretinore;
- D) zonat polare.

14. Era ndikon në ndryshimin e sipërfaqes së Tokës përmes veprimtarisë së saj shkatërruese, transportuese dhe depozituese.

a) Si quhet veprimtaria shkatërruese e erës, kur ajo **NUK** mbart material?

1 pikë

b) Jepni dy nga kushtet kur kjo veprimtaria shkatërruese është më e madhe.

2 pikë

15. Cili nga rajonet e Evropës është më shumë i prekur nga emigracioni?

1 pikë

- A) Rajoni i Evropës Lindore.
- B) Rajoni i Evropës Perëndimore.
- C) Rajoni i Evropës Veriore.
- D) Rajoni i Evropës Ishullore.

16. Rajoni i Evropës Ishullore dallohet për një klimë:

1 pikë

- A) oqeanike;
- B) ekuatoriale;
- C) tropikale;
- D) mesdhetare.

17. Lumi më i gjatë që derdhet në detin Mesdhe është:

1 pikë

- A) Danubi;
- B) Reni;
- C) Vollga;
- D) Nili.

18. Pasuria kryesore e rajonit të Afrikës Veriore-Azisë Jugperëndimore është:

**1 pikë**

- A) diamanti;
- B) argjendi;
- C) nafta;
- D) ari.

19. Cili është kufiri natyror midis Evropës dhe Azisë?

**1 pikë**

- A) Malet Urale.
- B) Fusha Ruse.
- C) Lumi Danub.
- D) Deti i Vdekur.

20. Spanja shtrihet në gadishullin:

**1 pikë**

- A) Apenin;
- B) Iberik;
- C) Skandinav;
- D) Bretanjës.

21. Rajoni më i madh bujqësor-blegtoral i Amerikës së Veriut është:

**1 pikë**

- A) Ultësira e Misipit;
- B) Ultësira Atlantike;
- C) Ultësira e Kolorados;
- D) Ultësira e Rio Grandes.

22. Shkruani tri veçori fiziko-gjeografike (në aspektin e pozitës gjeografike dhe relievit) të rajonit të Evropës Ishullore.

**3 pikë**

---



---



---



---

23. Jepni tri nga tiparet e popullimit të rajonit të Azisë Jugore.

**3 pikë**

- \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_


- \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

24. Në figurë paraqiten dy piramida popullsie.



a) Cilët janë faktorët kryesorë që përcaktojnë formën e piramidës së popullsisë?

2 pikë

---



---

b) Nxirrni dy ndryshime midis piramidës A dhe piramidës B të popullsisë.

2 pikë

---



---

25. Përcaktoni dy nga veçoritë dalluese të pozitës gjeografike të Australisë.

2 pikë

---



---



---



---

26. Për t'ju përgjigjur pyetjeve të mëposhtme bazohuni në hartën e dhënë.

a) Cili rajon tregohet në hartë?

1 pikë

---

b) Identifikoni një nga lumenjtë më të rëndësishëm të këtij rajoni, që derdhet në oqeanin Atlantik.


1 pikë

---

c) Cilat janë vargjet kryesore malore të këtij rajoni?

1 pikë

---



27. Cili nga rajonet e Shqipërisë dallohet për dendësinë më të lartë të popullsisë?

1 pikë

- A) Rajoni Verior – Verilindor.
- B) Rajoni Perëndimor.
- C) Rajoni Juglindor.
- D) Rajoni Jugor.

28. Liqene akullnajorë në Shqipëri janë ato të:

1 pikë

- A) Lurës;
- B) Darsisë.
- C) Dumresë;
- D) Ulzës.

29. Alpet Shqiptare ndërtohen kryesisht nga shkëmbinj gëlqerorë dhe dallohen për lartësi të mëdha. Cilat janë format e relievit që mbizotërojnë atje?

1 pikë

- A) Gropat dhe fushëgropat.
- B) Format karstike dhe cirqet.
- C) Luginat e gjera lumore dhe deltat.
- D) Rrëshqitjet dhe relievi i degraduar nga erozioni.

30. Bregdeti i detit Jon dallohet për:

1 pikë

- A) plazhet ranore;
- B) plazhet zallore;
- C) lagunat e shumta;
- D) kordonët litorale.

31. Rajoni Perëndimor karakterizohet nga një reliev kryesisht fushor. Dy nga pjesët përbërëse të tij janë: pllaja e Dumre-Darsisë dhe kodrat e Kërrabës. Jepni dy ndryshime midis zonës së Dumresë dhe asaj të Darsisë dhe një karakteristikë të kodrave të Kërrabës.

3 pikë

Dy ndryshime midis zonës së Dumresë dhe asaj të Darsisë.

---

---

---

---

Një karakteristikë të kodrave të Kërrabës.

---

---

32. Në lidhje me popullimin e Rajonit Jugor përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- a) Si është dendësia mesatare e popullimit të Rajonit Jugor në raport me mesataren e dendësisë së popullsisë në vend? **1 pikë**

---

- b) Jepni dy nga arsyet që kanë ndikuar në dendësinë mesatare të popullimit të Rajonit Jugor. **2 pikë**

---

33. Jepni nga një karakteristikë të Rajonit Juglindor në lidhje me: **3 pikë**

- ndërtimin gjeologjik të rajonit:

---

---

- format e relievit që mbizotërojnë:

---

---

- llojin e klimës:

---

34. Gjatë ecuresë së zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior-Verilindor dallohen disa periudha me karakteristika të veçanta:

- deri në vitin 1945;
- nga viti 1945 deri në vitin 1990;
- Pas vitit 1990

Evidentoni nga një karakteristikë të zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior-Verilindor për secilën nga periudhat. **3 pikë**

---

---

---

---

---

---

---

---